



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES



3-9 MARS

JAVA E MBROJTJES



KAMPUSI I RI I AFA

Kampusi i ri i Akademisë së Forcave të Armatosura, i cili po ndërtohet sipas modelit të një prej **akademive** më të mira në SHBA, **West Point**, është drejt finalizimit të fazës së parë të projektit. Akademia e re do të ketë si fillim **300 studentë**. Kryeministri **Edi Rama**, së bashku me Ministrin e Mbrojtjes, Pirro Vengu, panë nga afër punimet në këtë **kantier**.



“BUTRINTI” SHPËTON EMIGRANTËT NË EGJE

Gjatë patrullimit në **Detin Egje**, anija “Butrinti” gjatë kësaj jave realizoi dy operacione shpëtimi (**SAR**), duke u ardhur në ndihmë dy **gomoneve**: njëra me 32 emigrantë nga Afganistani, e nisur nga Çeşme me destinacion ishullin **Chios**, dhe tjetra me **36 emigrantë** nga Lindja e Mesme me të njëjtin destinacion.

JM





TAKIME NË BRUKSEL

Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, zhvilloi një vizitë në Bruksel ku kreu një seri konsultimesh me drejtuesit e strukturave të mbrojtjes dhe sigurisë të Bashkimit Evropian, ku kryefjala e këtyre ditëve është ri-armatosja dhe fuqizimi i industrisë ushtarake.

JM





SHQIPËRIA, PJESË E “MILITARY ERASMUS”

Shqipëria tashmë është pjesë e programit “Military Erasmus”. Ky program do t’u mundësojë së shpejti kadetëve të Forcave të Armatosura të formohen në më shumë se 10 shkolla ushtarake të vendeve të Bashkimit European.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES



KURSI PËR SIGURINË DHE MBROJTJEN

Në Kolegjin e Mbrojtjes dhe Sigurisë ka nisur **Kursi i Lartë** për Sigurinë dhe Mbrojtjen, me **pjesëmarrjen** e përfaqësuesve nga **FARSH**, institucionet e sigurisë në vend, si dhe përfaqësues të vendeve të **NATO-s**. Për zv/ministren e Mbrojtjes, Blerina Abrazhda, në një epokë ku sfidat e **sigurisë** po bëhen më **komplekse**, rritet nevoja për udhëheqës dhe ekspertë të përgatitur.



EKIPI I GARDËS SË NEW JERSEY NË AFA

Komandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura, Gjeneral Brigade Bardhyl Nuredinaj, priti në një takim ekipin e **Gardës Kombëtare të New Jersey**, ku koordinuan detajet e stërvitjes fushore që do të zhvillohet në **prill 2025**. Kjo stërvitje synon rritjen e aftësive operacionale dhe **bashkëpunimin** ndërkombëtar.





TAKIME ME TË RINJTË

Qendra e Personelit Rekrutimit, në bashkëpunim me Akademinë e Forcave të Armatosura, **organizuan** “Ditë të Hapura” me të rinjtë në Fier, Roskovec , Patos dhe Ballsh. Ata patën mundësinë të **njihen** nga afër me rolin, misionin e **FA-së** si dhe mundësitë për t’u bërë pjesë tyre.

JM

